



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:252386

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05847060

KPPP.nr. 1917/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit VAC DISTRIBUTION SH.P.K., me numër unik identifikues 811874420 me seli në Prishtinë, rr. "Tahir Zajmi" p.n, kundër debitorit SUPER VIVA SH.P.K., me numër unik identifikues 810800385, me seli në Prishtinë, Zona Industriale p.n., duke vepruar sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor, P.nr.1779/23, i lejuar me datë 23.10.2023, nga Përbaruesi Privat, Isa Gacaferri në Prishtinë, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit SUPER VIVA SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor , P.nr.1779/23, i lejuar me datë 23.10.2023 nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferri.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor, P.nr.1779/23, i lejuar me datë 23.10.2023, të Përbaruesit Privat Isa Gacaferri.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, Isa Gacaferri duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit të kreditorit VAC DISTRIBUTION SH.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës me numër 22-SHV01-001-80 e datës 11.03.2022 me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t'ia paguaj kreditorit shumën prej 5,754.20€ (pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër euro e njëzet cent), si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm. Në të kundërtën përbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare, sekuestrimin, e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasomi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori, ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbarimit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbarimor, për pagesën e faturës së lëshuar nga kreditori VAC DISTRIBUTION SH.P.K., me arsyetimin se propozimi për përmbarim ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore si dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Debitori thekson se fatura nuk përmban as nënshkrim e kreditorit dhe as nënshkrimin e dërguesit të mallit, përveç kësaj sqaron se fatura mund edhe të mos jetë pranuar fare nga autoriteti gjegjës tek debitori, ndërsa për nënshkrimet e vëna gjoja në emër të debitorit janë nënshkrime vështirë të deshifrueshme. Më tutje sqaron se mbështetur në komunikimet e ndërjella të palëve përmes telefonit dhe e-mail, ka qenë kreditori i cili më datën 23.05.2022 përkshkruan dy kartela të subjekteve, njëra kartelë me prerje detyrimi për periudhën 01.01.2022 deri 31.10.2023, borxh i konfirmuar për pagesë në barrë të debitorit në shumën prej 2,064.20€, ndërsa kartela me datë të njëjtë, në shumën prej 5,754.20€. Më tutje më datën 27.10.2022 Kreditori përmes një përgjigje të dhënë me e-mail, konfirmon se në mungesë të dy faturave të pa konfirmuara, të njëjtat janë larguar nga kartela/obligimi, dhe borxhi i debitorit për pagesë mbetet të jetë shuma 2,064.20€. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të anulohet në tërësi urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferri, me numër, P.nr.1779/23, i lejuar me datë 23.10.2023.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet*

dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht – Faturën me numër 22-SHV01-001-80 e datës 11.03.2022 e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është i përshkruar objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e protokollimit të debitorit. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën dhe nënshkrimin e pranimin të debitorit.

Gjykata vlerësoi edhe komunikimet me e-mail mes kreditorit dhe debitorit të cilat janë dorëzuar nga debitori së bashku me prapësim por vlerësoi se ky komunikim lidhur me kartelat financiare nuk është realizuar me përfaqësuesin e kreditorit por me përfaqësuesin e shoqërisë Quatra Audit Int. LLC, ashtu që gjykata nuk arriti të vërtetojë ndërlidhjen në mes të kësaj shoqërie dhe kreditorit, andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1917/23, datë 21.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.